

- 
- ▲ Imami dhe
xhemati
 - ▲ Nexhat Ibrahimini





© LOGOS - A


2 0 0 5



S H K U P

P R I S H T I N ē

T I R A N ē



▲ Nexhat Ibrahimî
▲ Imami dhe
▲ xhemati





▲ Nexhat Ibrahimim
▲ Imami dhe
▲ xhemati



Permbajtja:

I. Hyrje	9
II. Bashkëpunimi ndërmjet imamit dhe xhematlinjve.....	14
III. Edukimi islam në familjen bashkëkohore	18
IV. Pengesat thelbësore për komunikim cilësor ndërmjet imamit dhe xhematlinjve	22
V. Vërejtjet e ndërsjella imam - xhemat	25
A. Vërejtjet e imamit ndaj xhematlinjve	25
B. Vërejtjet e xhematlinjve ndaj imamit	27
VI. Planifikimi dhe format e bashkëpunimit ndërmjet imamit dhe xhematlinjve	30
1. Kontaktet individuale ndërmjet imamit dhe xhematlinjve	31
2. Mbledhjet prindërore.....	35
3. Arsimimi i përgjithshëm dhe pedagogjik islam.....	36
4. Organizimi i aksioneve të përbashkëta në xhemat.....	37
5. Bibliotekat, sallat e leximit, lokalet për pushim, argëtim e rekreim	38
6. Pjesëmarrja e xhematlinjve në fushat e tjera të jetës dhe të punës së xhematit	39
VII. Literatura e konsultuar:	41

*“Ai, dy ditët e të cilat janë të njëjtë (në arritje),
është në humbje të sigurt.”¹*

I. Hyrje

Nuk ekziston ndonjë formulë magjike e cila mund t'i zbulojë fshehtësitë e hulumtimeve organizative, ashtu siç nuk ekzistojnë as veprime mekanike të cilat kur të mësohen dhe përvetësohen, e përgatitin njeriun për këtë lloj veprimtarie.² Organizimet janë të shumta dhe suksesi i tyre varet nga shumë faktorë. Njëri ndër faktorët më kryesorë është bashkëpunimi ndërmjet imamit³ dhe xhematlinjve⁴ në punën edukative-arsimore, i cili sa është aktual, aq është edhe kompleks, veçanërisht në periu-dhën e fillimit të shekullit XXI. Ky aktualitet dhe kompleksivitet konsiston me disa faktorë të cilët shfaqen si rezultat i zhvillimit të shpejtë të sistemit edukativo-arsimor të botë, pastaj nga roli gjithnjë më i madh i tyre, respek-

¹ *Men istewâ jewmâbu fehuwe magbûne.* Sipas: *Sunen'ud-Dejlemi*.

² Shih gjerësish: Hisham Et-Talib, *Udhëzues përgatitor për punonjësit islamicë*, Shkup, 1419 h./1998, fq. XI.

³ *Imam* është fjalë arabe që, me kuptime të ndryshme përmendet në Kur'an në disa raste: shenjë, shembull, udhëheqës, lider etj., kurse në përdorimin e përditshëm përdoret kryesisht në dy kuptime: 1. Imami si udhëheqës në namaz; 2. Imami si halif apo si dijetar i njohur (Imam Ebu Hanifeh, Imam El-Gazaliu) etj. Shih: N. Smailagić, *Leksikon islamia*, Sarajevë, 1990, fq. 267.

⁴ *Xhemat* është fjalë arabe me domethënë tubim, kuvend apo grup besimtarësh. Xhematliu është pjesëtar i xhematit. Shih: N. Smailagić, op. cit., 155.

tivisht nga roli që duhet ta kenë imamët dhe xhematlinjtë në punën dhe jetën edukativo-arsimore të Bashkësisë Islame⁵ dhe të shoqërisë në tërsi.⁶

Rezultatet që janë arritur në këtë fushë nuk mjaftojnë as në aspekt të llojlojshmërisë së formave organizative, as në aspekt të cilësisë së përbajtjes së sendërtuar, e as në aspekt të rezultateve të dukshme që janë shënuar.⁷ Janë disa arsyе për këtë gjendje, të cilat në vija të përgjithshme mund të përmblidhen në këtë:

1. Bashkëpunimi i imamit dhe xhematlinjve nuk është bazuar në standarde të sigurta dhe të shëndosha pedagogjiko-didaktike të cilat do të ofronin garancë përlidhje më të fortë reciproke, për veprimtari më efikase edukative dhe, në përgjithësi, për ndikim më konceptual në xhemat përgjithësisht.

2. Imamët dhe organet e institucionet islame te ne nuk janë marrë në mënyrë serioze dhe kompetente me studimin e bashkëpunimit të imamit dhe të xhematlinjve dhe janë bërë relativisht pak, gjegjësisht fare pak, humumtime në fushën e veprimitarisë së imamit, mualimit, hatibit, profesorëve të medreseve e të fakultetit islam.

⁵ *Bashkësia Islamë* është “Bashkësi e vetme dhe unike islamë e të gjithë pjesëtarëve të besimit islam ...”. Sipas:

Kushtetuta e Bashkësisë Islame, Prishtinë, 2002, fq. 5.

⁶ Me termin *arsimim* nënkuqtojmë përfitimin e diturisë që mund të vihet në zbatim për përmirësimin e aftësive njerëzore, sjelljes dhe shkathtësive nëpërmjet përgatitjes dhe zhvillimit. Sipas: Hisham Et-Talib, *Udhëzues përgatitor për punonjësit islamikë*, Shkup, 1419 h./1998, fq. XXIII.

⁷ Pa marrë parasysh mendimet e shumta, bazë e palëkundshme për edukimin dhe arsimimin e xhematlinjve janë Kur'ani dhe Hadithi. Shkollat e shumta tregojnë se bazë e lëvizjeve që kanë bërë kthesa në histori janë mësimet kur'anore dhe sunnetike. P.sh. Lëvizja e Abdulvehhabit, Afganiut dhe Abduhusë, Hasan Bennas dhe lëvizja e Homeninit janë tregues të mjaftueshëm për konstatimin tonë. Shih: Fethi Jeken, *Islamic Movement*.

Më mirë thënë, përpjekjet e deritashme janë më shumë të rastit, të çastit, tutinore, sipërfaqësore dhe jokompetente, sesa produkt i një pune sistematike, studioze, analitike dhe multidisiplinore.⁸

3. Nuk janë sigruar dhe krijuar kushte përkatëse psikike dhe materialo-teknike për bashkëpunim më të organizuar ndërmjet imamit dhe Bashkësisë Islame dhe ndërmjet imamit dhe xhematlinjve. Po ashtu, nuk janë ndërtuar apo nuk janë sigruar hapësira adekuate për punën e imamit dhe të xhematlinjve, pastaj mungojnë mjetet për ekzekutimin e programit edukativo-arsimor manuel, vizuel dhe elektronik për përkryerjen e tyre të përgjithshme dhe pedagogjiko-didaktike.

Pasojat e faktorëve të theksuar me këtë rast dhe të mungesave të tjera që nuk janë theksuar këtu janë bashkëpunimi i keq dhe i dobët, joadekuat dhe i pamjaftueshëm. Kjo gjendje ka rezultuar me:

- Moskuptim të plotë të aksionit të përbashkët pedagogjik;
- Mosinteresim të mjaftueshëm për kontakte të përbashkëta, mosbesim dhe akuzim reciprok, si dhe lëshime evidente në punën e përditshme edukativo-arsimore.⁹

⁸ Nevojën e madhe për vepra origjinale në fushë të da'ves (thirrjes në islam) e kanë zbutur disa vepra të përkthyera, si ajo e Hisham Et-Talibit, *Udhëzues përgatitor për punonjësit islamikë*, Shkup, 1419 h./ 1998.

⁹ Një anekdotë do të ishte e mirëseardhur për dashurinë dhe bashkëpunimin e ndërsjellë: Një mbret, i cili e donte shumë mjaltin e shtrenjtë, dëshironte të kuptojë se sa shumë e donte populli atë. Ai vuri një fuçi të zbrazët në qendër të qytetit dhe shpalli: secili që e donte atë duhej të zbrachte një kupë mjaltë në fuçi. Njëri mendoi se, pasi që çdokush tjetër zbrachte mjaltë, ai mund të zbrachte një kupë ujë. Tekefundit, një kupë nuk do të vërehej në fuçinë përplot me mjaltë. Kur mbreti më vonë e hapi fuçinë, ajo ishte përplot me ujë. Siç duket, secili e kishte pasur idenë e njëjtë.

Gjendja e këtillë e pranishme me vite e me dekada, nga një anë, dhe borxhi ndaj të atyre që kanë nevojë për dituri, në anën tjetër, ka nxitur dhe ka motivuar që theksi të vendoset në çështjet vijuese:

- Bashkëpunimi ndërmjet imamit dhe xhematliut për punën e suksesshme të mësim-besimit;
- Kushtet e edukimit islam në familjen tonë bashkë-kohore;
- Problemet thelbësore të komunikimit të ndërsjellë ndërmjet imamit dhe xhematliut;
- Vërejtjet e imamit drejtar xhematlinjve;
- Vërejtjet e xhematlinjve drejtar imamit;
- Planifikimi i bashkëpunimit ndërmjet imamit dhe xhematlinjve;
- Format e bashkëpunimit ndërmjet imamit dhe xhematlinjve.

Hulumtimet në terren dhe hulumtimet në dokumentacionin e Bashkësisë Islame, nëpër raporte të publikuara apo të lexuara nëpër tubime, tregojnë se ka shumë pika konstuese ndërmjet imamit dhe xhematliut, ku ata nuk mund të gjejnë gjuhë të përbashkët në punën e mësim-besimit, ku nuk mund t'i zgjidhin problemet e rëndësishme edukative dhe ku nuk angazhohen shumë në gjetjen e rrugëve dhe metodave më të mira për veprimtarinë e përbashkët.

Po ashtu, hulumtimet tregojnë se pa punë sistematike, pa aksione të shpejta dhe të përhershme në eliminimin e tërë asaj që ndan dhe rëndon raportet ndërmjet imamit dhe xhematliut, nuk mund të presim së shpejti përparim në fushën e mësim-besimit.

Ky punim nuk pretendon t'i përfshijë të gjitha problemet dhe të gjitha mundësitë për kapërcimin e problemeve të pranishme ndërmjet imamit dhe xhematliut, profesorit dhe nxënësit apo studentit në medrese e faktut, ndërmjet Bashkësisë Islame dhe imamëve dhe

Bashkësisë Islame dhe xhematlinjve, por orvatet që në vija të përgjithshme të shërbejë si platformë parimore në punën e imamëve, mualimëve dhe hatibëve, kryeimamëve, muftive e profesorëve dhe të gjithë atyre që në çfarëdo mënyre merren me punën e mësim-besimit në të gjitha nivelet: atë parashkollor, shkollor, fillor, të mesëm, apo të lartë.

II. Bashkëpunimi ndërmjet imamit dhe xhematlinjve

“... se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo për çka ai përpigjet, se (siyti nga) përpjekja e tij së shpejti do të shihet; pastaj ai do të shpërblehet me një shpërbirim të plotë.” (En-Nexhm, 39-41).

“Të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë ju jeni përgjeqjes për tufën tuaj: imami është bari i tufës së tij dhe do të përgjigjet për tufën e tij; burri është bari i familjes së tij dhe do të përgjigjet për tufën e vet; gruaja është bareshë e familjes së burrit të saj dbe do të përgjigjet për tufën e saj; shërbetori është bari i pasurisë së zotëriut të tij dhe do të jetë përgjeqjes për tufën e tij; fëmija është bari i mallit të prindit të tij dbe do të jetë përgjeqjes për tufën e tij. Me një fjalë, të gjithë jeni barinj dhe të gjithë ju jeni përgjeqjes për tufën tuaj.”¹⁰

Nga bashkëpunimi i organizuar në bazë të diturive dhe i orientuar në mënyrë pedagogjike ndërmjet imamit dhe xhematlinjve, varet shumë edhe perceptimi më i plotë dhe sendërtimi më praktik i synimeve të edukatës islame. Në kushtet e veprimit unik edukativo-arsimor të imamit dhe xhematlinjve nuk mund të ketë mosmarrëveshje më të mëdha në koncepcion, mjete dhe metoda të edukimit. Thua se nuk ka fushë, kur është në pyetje edukimi islam, në të cilin bashkëpunimi i këtyre dy faktorëve nuk është i domosdoshëm. Imami dhe xhematlinjtë para

¹⁰ Nga Ibn Umeri, *Muttefekun alejb, Suneni i Tirmidhiut, Suneni i Ebu Davudit.*

së gjithash janë përgjegjës për edukimin islam, gjegjësisht për përvetësimin e pikëpamjes islame mbi botën nga ana e vijuesit të mësim-besimit. Ata e kanë për detyrë edukimin fetar dhe moral dhe zhvillimin e vetëdijes, vullnetit, cilësive të mirësjelljes së mirë, këmbëngulësisë, humanitetit e të tjera, por edhe krijimin e ambientit dhe atmosferës në të cilën nxënësit e mësim-besimit do të fitojnë dashuri ndaj punës, do t'i ndërtojnë shprehitë e punës dhe vetëdijen për disiplinë të punës.

Prindërit dhe imamët duhet të dakordohen rrëth organizimit më bashkëkohor të mësim-besimit, rrëth aftësimit më të madh të nxënësve të mësim-besimit në kohën e zhvillimit të hovshëm të shkencës dhe teknikës, të automatizimit dhe të elektronikës në proceset prodhuase dhe në epokën e ndryshimeve të mëdha shoqërore dhe t'i plotësojnë dëshirat e të rinjve dhe kërkesat e Bashkësisë Islamë.¹¹

Këta kujdesen t'i plotësojnë kushtet materiale të mësim-besimit, ta ndërlidhin atë me mjedisin dhe ta bëjnë më efikas, kujdesen që faktori xhemat-prindëri dhe imam-mualim të kujdesen që fëmijët ta duan mësim-besimin, që me dëshirë të shkojnë në mësim-besim dhe me kënaqësi t'u përgjigjen detyrimeve të mësim-besimit, që në rrugë, në shkollë dhe në mjedise të tjera të sillen në mënyrë islame, të argëtohen me përbajtje të lejuara sipas shariatit dhe në mënyrë të organizuar. Të gjitha këto do të ndikojnë që fëmija, krahas tritjes dhe zhvillimit të

¹¹ Me termin *zhvillim* në kontekste të ndryshme në këtë shkrim ndër të tjera nënkuptohet tërësia e programeve që merren me rritjen apo mprehjen e shkathëtësive analitike dhe udhëheqëse, si dhe konceptimi për funksionet mbikëqyrëse dhe qeverisëse. Sipas: Hisham Et-Talib, *Udhëzues përgatitor për punonjësit islamikë*, Shkup, 1419 h./1998, fq. XXIII.

tij fizik, të zhvillohet edhe fetarisht dhe intelektualisht, t'i eliminohen vështirësítë eventuale dhe t'i jepet shenjë përlëshimet eventuale.

Me të drejtë shumë pedagogë dhe etikanë mendojnë se bashkëpunimi i imamit dhe xhematlinjve kontribuon përkthimisht aktivizimin dhe aftësimin e xhematlinjve-prindër për veprimtari pedagogjike, u mundëson atyre qasje të drejt-përdrejtë në punën e mualimëve dhe imamëve. Ata njoftohen edhe me reformat e kohëpaskohshme të mësim-besimit, njoftohen me literaturën e mësim-besimit dhe, në përgjithësi, me planet, projektet dhe nevojat e Bashkësisë Islame. Xhematlinjtë-prindër njoftohen drejtpërdrejt sesi t'i ndihmohet fëmijës, si ata t'i kapércejnë problemet e ndryshme, por edhe ofrojnë informata për jetën dhe kushtet e fëmijës në shtëpi, përvirgjitet dhe vlerat e fëmijës, por edhe përvirjet e tekut e tij.

Meqë bashkëpunimi i ndërsjellë imam-xhemat është faktor i rëndësishëm, ai duhet të jetë i organizuar në mënyrë të planifikuar, të jetë përbajtësor dhe i përherëshëm. Bashkëpunimi me xhematin nuk mund të kuptohet si punë rasti, çasti apo punë fushate. Ai duhet të jetë i konceptuar mirë, i organizuar dhe i planifikuar dhe vazhdimesht duhet të jetë brengë e imamit. Imami patjetër duhet ta ketë parasysh faktin se xhematliu më nuk formohet vetëm në xhami, por edhe nëpërmjet shtypit, mjeteve audio dhe video, pastaj mjeteve elektronike (radiotelevizioni, interneti) dhe formave të tjera, organizimeve të tjera në forma sporti, kulture, rekreimi etj. Imami duhet t'i ketë parasysh këto risi, t'i kanalizojë, t'u japë formë zyrtare dhe, në bashkëpunim me kryeimamët dhe bashkësitë komunale islame, këto forma t'i avancojë.

Të gjitha aktivitetet dhe format e bashkëpunimit do të jenë në funksion të vetëdijësimit dhe të aftësimit të njeriut të ri, por edhe të të moshuarit që të jetojë i pava-

tur si besimtar aktiv kundrejt të gjitha sfidave dhe negativiteteve në shoqëri, si: alkoolizmi, prostitucioni, pornografia, orgjité e ndryshme, shundi dhe kiçi. Të gjitha këto tregojnë se bashkëpunimi ndërmjet imamit apo mualimit dhe Bashkësisë Islame, nga një anë, dhe nxënësve të mësim-besimit dhe prindërve të tyre, në anën tjeter, është i domosdoshëm:

“... Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e në armiqësi. ...” (El-Maide, 2).

“... E kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llabun, se All-llahu i do ata që i mbështeten.” (Ali Imran, 159).

III. Edukimi islam në familjen bashkëkohore

“Njerëzit janë si xehet. Kështu, më i zgjedburi prej tyre në xhabilijet (injorancë), do të jetë më i zgjedburi edhe në islam; nëse e përvetëson (pranon) islamin.”¹²

Në bazë të pikëpamjeve tradicionale dhe hulumtimeve më të reja nga përditshmëria jonë, mund të përfundohet se familja është shumë me rëndësi për edukimin e fëmijëve. Në familje arrihen njojuritë, shkathësitë dhe shprehitë e para, fitohen cilësitë fundamentale të karakterit, të vullnetit, si dhe cilësitë emocionale të personalitetit dhe vendosen bazat e pikëpamjeve mbi botën dhe bindjet themelore jetësore.

“O ju që besuat, ruane veten dbe familjen tuaj prej një zjarni, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dbe gurët...” (Et-Tahrim, 6).¹³

Në këtë frymë janë edhe fjalët e Muhammedit a.s.:

¹² *En-Nâsu meâdinu bijârûbum fi'l-xbâbilijjeti bijârûbum fi'l-islâmi, idhâ fekuhû.* Hadith i Muhammedit a. s., Transmeton: Buhariu, Muslimi, Darimi u dhe Ibn Hanbeli.

¹³ Ibn Abbasi, njëri prej komentatorëve më kompetent të Kur'anit lidhur me këtë ajet pohon: “Bëhuni të dëgjueshëm ndaj All-llahut të madhëruar, ruajuni dhe kini kujdes që mos t'i theni rregullat ndaj Tij. Porositni anëtarët tuaj në Kur'an që All-llahu t'ju ruajë nga zjarrri.” Shih: *El-Kur'an'ul-kerim ve bishamishibi Temir'ul-mikbasi min tefsiri Ibn Abbas* nga Ebu Tahir Muhammed ibn Ja'kub El-Fejruz Abadi Esh-Shafî'ij, botimi I, Bejrut, Liban, 1409 h./1988, fq. 560-561.

Krhs.: *Prijevod Kur'ana sa tefsiron i komentarom na bosanskom jeziku*, Munih, botimi I, 2001, vëllimi V, fq. 2461.

“Çdo fëmijë lind në fenë e pastër, natyrore, e pastaj prindërit e edukojnë si hebraik, kristian apo zjarradburnes.”¹⁴

Rëndësia e familjes në edukim kërkon nga xhematliu-prind kujdes të pérhershëm dhe të gjithanshëm pér zhvillimin e fëmijëve, pér socializimin, emancipimin dhe aftësimin e fëmijëve që në mënyrë korrekte t'i kuptojnë dhe t'i kryejnë dispozitat fetare. Kjo rëndësi e obligon edhe Bashkësinë Islam, sidomos imamin, që t'i ndihmojë xhematliut-prind në kapërcimin e vështirësive të shumta pér edukim më të lehtë, më të shpejtë dhe në mënyrë më efikase.

Nuk mund të mohohet se një numër i familjeve muslimane dhe disa imamë nuk janë në nivel të detyrave edukative që i kanë. Prindërit sot i kanë disa parakushte që t'u ofrojnë fëmijëve një njohje solide fetare dhe materiale pér hyrje në martesë, kurse imamët nëpërmjet hutbeve, këshillave, gazetave e librave fetare dhe mjeteve të tjera si radiotelevizioni e interneti, mund të flasin dhe shkruajnë pér rëndësinë e martesës islame, pér obligimet prind-fëmijë dhe fëmijë-prind etj.

Megjithatë edhe përkundër përpjekjeve të punëtorëve fetarë, janë evidente edhe lëshimet dhe trendet negative në fushën e bashkëpunimit të imamit dhe xhematliut-prind dhe bashkësisë islame-imamit dhe xhematliut-prind. Kontakti i drejtpërdrejtë dhe reagimet nëpër shtyp tregojnë se faktorët e përmendur më lart nuk kanë punuar sa duhet në ngritjen edukativo-arsimore islame të qytetarit, nuk kanë treguar me sukses në braktisjen e traditave joislame, në përgatitjen e gjithanshme pér ballafaqim me rrymat dhe trendet e shumta çoroditëse përreth besimtarit. Në këtë proces vërehen edhe disa faktorë ob-

¹⁴ Sipas: *Hadithe të zgjedhura të Pejamberit alejbisselam*, Përgatiti: Jakup Memiq, hadithi numër 1193, Tetovë, 2003, fq. 276.

jektiv që ndihmojnë lajthitjen e të riut, si punësimi i të dy prindërve dhe lënia e fëmijëve pa kujdes të mjaftueshëm, ndikimi i vazhdueshëm negativ i mjeteve të shumta të komunikimit, si radiotelevizioni, gazeta, libri, kinemaja, video-klubet, interneti e të tjera, pastaj ndikimi i rrugës etj.

Mirëpo, ekzistojnë edhe shumë faktorë subjektiv, ku fajtor në detyrën e mosedukimit të brezit të ri është xhematliu-prind dhe imami-bashkësia islame. Disa xhematlinj-prind përgjegjësinë e tyre dëshirojnë t'ia hedhin tjetërkujt, duke i ngushtuar detyrimet e tyre në kujdesin fizik, në ushqim e veshmbathje, e herë-herë edhe në ndëshkimin fizik, duke ia hedhur fajin imamit, bashkësisë islame dhe të tjerëve. Po ashtu, disa prindër në procesin e edukimit të fëmijëve përdorin një sistem edukimi, duke mos e përfillur individualitetin e secilit fëmijë veç e veç. Ky është një lëshim edhe i disa imamëve, të cilët nuk i përfillin aftësitë psiko-fizike të nxënësit, ngase nuk mund të priten rezultatet e njëjta nga të gjithë nxënësit, edhe pse kushtet materiale pothuajse janë të njëjta për të gjithë. Nuk ka rregulla dhe receta të përgjithshme. Nëse kësaj ia shtojmë edhe mospërgatitjen e imamit për procesin edukativo-arsimor, mosrregullsinë në orarin e punës, sjelljet arrogante dhe mosnjohjen e metodave pedagogjike, atëherë mossuksesi është shumë afër. Nëse në këtë angazhim xhematliu-prind luan rol destruktiv, duke e zhvlerësuar imamin dhe institucionin, nëse nuk i jep përkrahje morale imamit dhe bashkësisë islame dhe nëse nuk merr pjesë në ndihma materiale institucionale, kjo do të ndikojë negativisht te fëmija, i cili do të krijojë bindje të keqe për këta faktorë dhe puna do të ngecë e do të gjykohet në mossukses dhe dështim.

Pa dyshim se Bashkësia Islame dhe imamët po bëjnë përpjekje për avansimin e procesit edukativo-arsimor për ta ndihmuar xhematliun-prind me ndërtimin e xha-

mive të reja dhe medreseve, pastaj përmes ligjëratave, këshillimeve dhe formave të tjera në xhami, programeve kulturo-artistike, seminareve, tribunave, simpoziumeve, gazetave e revistave, e kohëve të fundit, edhe përmes internetit. Po bëhen përpjekje që njerëzve të rinj t'u jepet shenjë në lajthitjet politike, ekonomike, sociale e kulturore në shoqëri, si dhe në çoroditjet më të vrazhda në rrëthim tonë më të afërt, siç janë: duhani, alkooli, droga, pornografia dhe prostitucioni me të gjitha format e veta. Mirëpo, të gjitha këto janë shumë pak në krahasim me ato që ofrohen nga shtetet e ndryshme nëpërmjet fondacioneve e shoqatave kulturore, humanitare e bamirëse në emër të lirive njerëzore, lirisë së femrës, seksit të lirë, edukimit qytetar¹⁵ etj.

Imami, bashkësia islame dhe xhematliu-prind duhet të kenë bashkëpunim aktiv, të llojillojshëm, intelektual dhe material e moral për t'i përballuar kështu vështirësitë e shumta. Ata duhet ta ndjejnë problemin, ta diagnostikojnë, ta përshkruajnë zgjidhjen e tij, ta planifikojnë zbatimin dhe ta ndjekin zbatimin hap pas hapi deri në fund.¹⁶

All-llahu i madhëruar thotë: “*Detyrë jona është vetëm të udhëzojmë.*” (El-Lejl, 12).

¹⁵ Në Kosovën e pasluftës shoqatat e ndryshme perëndimore, rinisë kosovare i ofruan “prezervativë” në vend të bukës, i ofruan shfrenim (nëpërmjet dashurisë së lirë e perverse dhe alkoolit) në vend të dashurisë së mirëfilltë. Përpjekje të tillë pati dhe ka në Prizren, Prishtinë, Pejë dhe në qytetet e tjera të Kosovës.

¹⁶ Shih gjerësisht: Hisham Et-Talib, *Udbëzues përgatitor për punonjësit islamikë*, Shkup, 1419 h./1998, fq. 102.

IV. Pengesat thelbësore për komunikim cilësor ndërmjet imamit dhe xhematlinjve

“Kjo fe është e fuqishme, prandaj hyni në të në mënyrë të butë dhe të dashur.”¹⁷

Domosdoshmëria e bashkëpunimit ndërmjet imamit dhe xhematliut është e pakontestueshme. Këtë konstatim e dëshmojnë akuzat e ndërsjella. Shumë xhematlinj-prindër janë të pakënaqur me format e bashkëpunimit që i ofron imami. Mungojnë takimet apo mbledhjet sistematike, madje edhe nëse ndonjëherë ekzistojnë, ato takime janë rutinore, stereotipe, jointeresante dhe joaktuale. Shumë imamë janë të vrazhdë, aksionet e Bashkësisë Islame i paraqesin para xhematlinjve si aksione “të atyre lartë”, ndërsa disa imamë aktivitetin e vetëm e kanë në kërkimin e ndihmave materiale apo në paraqitjen reprezentative para xhematit, si: mevludet, tevhidet, falja e xhenazeve dhe këshillave. Në shumë raste, këshillat e imamëve nuk janë kritikë konstruktive, por kritikë “për vete” ndaj xhematit, xhematlinjve, fëmijëve të tyre etj. Ka raste kur imami dhe Bashkësia Islame e nënçmon apo e mbiçmon rolin e xhematliut, nuk i konsiderojnë ata për bashkëpunëtorë të barabartë, ndaj xhematit sllen administrativisht dhe mossukseset e tyre i arsyetojnë me

¹⁷ *Inne hadbe'ddine metinun fe ewgil fibi bi rifkin*, hadith sipas: Ibn Hanel, Musnedi.

rrrethanat e këqija në xhemat, kurse indiferencën e një pjese të xhematit ndaj imamit dhe Bashkësisë islame e arsyetojnë me vullnetin e Allahut, me mosdëshirën e xhematliut, por jo edhe me mospunën e vet.

Në anën tjetër, imami dhe Bashkësia islame kanë vërejtje se shumë xhematlinj rrallë vijnë në xhami, fare pak apo aspak interesohen për mbarëvajtjen e Bashkësisë Islame dhe atë nuk e konsiderojnë obligim të tyre të përhershëm, nuk kujdesen për arsimimin dhe edukimin e tyre fetar, ndërsa për dështimet në edukimin e fëmijëve e fajësojnë shkollën, xhaminë, imamin, shokët e lagjes apo të shkollës dhe mjedisin ku jetojnë, ashtu që shpesh pa të drejtë i kritikojnë imamët dhe Bashkësinë Islame. Ata përpiken që obligimet e tyre ndaj fëmijëve t'i reduktojnë në ushqim, veshimbathje dhe mbrojtje fizike. Po ashtu, ata nuk i harmonizojnë sjelljet e tyre me ato që imami kërkon dhe po këtë gabim e bëjnë ndaj fëmijëve të tyre, duke insistuar që ndaj të gjithë fëmijëve të sillen njësoj, duke ua mohuar atyre individualitetin dhe dinjitetin e tyre. Të tillët dështojnë si në familje, ashtu edhe në xhemat, andaj edhe përpiken që me autoritetin e tyre të rrejshëm të dominojnë.

Një faktor tjetër me rëndësi në këtë konstelacion raportesh është edhe organizimi i dobët i këshillit të xhematit dhe imamit, i këshillit të xhematit, imamit dhe Bashkësisë Islame. Bashkëpunimi i tyre është i organizuar pa plan, kohë pas kohe dhe në mënyrë jopërkatëse, andaj edhe është joefikas.

Nëse i bëjmë një përbledhje akuzave të ndërsjella ndërmjet imamit dhe xhematit, do të fitonim gjendjen vijuese:

1. Nuk ekziston bashkëpunim i fortë, i përhershëm, i sinqertë dhe efikas ndërmjet xhematlinjve dhe imamit.

Raportet e tyre shpesh shquhen me neglizhencë, formalizëm dhe improvizime, e herë-herë edhe me zënka.

2. Medresetë tona dhe fakulteti ynë islam, por edhe qendrat universitare në botën arabo-islame kanë lëshime të shumta në formimin edukativo-arsimor dhe misionaro-pedagogjik të kuadrit fetar; ata nuk janë në hap me të arriturat botërore, të cilat reflektohet edhe në punën efikase të imamëve me xhematin.

3. Ndikimi edukativ i familjes, i imamit dhe i bashkësive islame te ne nuk është në hap, si në cilësi ashtu edhe në sasi, me ndikimin e mjeteve informative të shkruara dhe elektronike të mjedisit.

4. Mungojnë objektet e veçanta dhe mjetet e tjera përkatëse për komunikim ndërmjet imamit dhe xhematit, por mungon edhe tradita në këtë aspekt. Është interesant se në këtë aspekt “alergjik” ndaj risive janë si xhamati ashtu edhe imami. Edhe njëra edhe tjera palë i neglizhojnë dhe disi u frikësohen detyrimeve dhe përgjegjësive të reja;

5. Niveli i ulët edukativo-arsimor i xhematit. Në disa mjedise ende ka xhematlinj analfabetë. Me analfabetë i nënkuuptojmë edhe ata që ende nuk dinë shkrim-lexim, por edhe ata që në islam janë analfabetë. E, të tillë ka shumë.

6. Flktuimet, lëkundjet ideore (medhhebore etj.) të kuadrit fetar janë pengesë serioze për bashkëpunimin serioz ndërmjet imamit dhe xhematit. Derisa xhamati beson dhe praktikon një medhheb kaherë të përvetësuar, imami ligjëron, këshillon dhe praktikon ritualet tjetërfare sipas medhhebit tjetër, duke kritikuar medhhebin ekzistues si anakronik, jo fort islam apo fare joislam.

7. Imamët nuk janë të stimuluar materialisht në të gjitha vendet për angazhimin e tyre, andaj ata kryesisht bashkëpunojnë me xhematin vetëm kur është e domosdoshme dhe atëherë kur kanë kompensim material.

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkafërderdheshin prej teje ... ”. (Ali Imran, 159).

V. Vërejtjet e ndërsjella imam - xhemat

“Po nese ju i ktheni shpinën (rrugës së drejtë), Ai do t’ju zhendësojë me një popull tjeter, që nuk do të jetë si ju.”
(Muhammed, 38).

A. Vërejtjet e imamit ndaj xhematlinjve

Në bazë të bisedave me imamë të ndryshëm apo të përshtypjeve të imamëve me rastin e takimeve, seminareve e vizitave e të tjera, vërejtjet kryesore të imamëve ndaj xhematlinjve janë si vijon:

1. Xhematlinjtë nuk janë të interesuar, në veçanti për problemet e xhematit, për punën e mësim-besimit, për nxënësit e mësim-besimit dhe për punën dhe problemet e imamit. Si në takimet ditore (namaze) ashtu edhe në takimet e tjera (xhumaja, bajramet, netët e mëdha apo ndonjë jubile apo rast solemn), nga xhamia mungojnë mbi 60-80 % të xhematlinjve meshkuj dhe thuajse 99 % të xhematlinjve femra.

2. Shumë xhematlinj nuk e njojin thelbin e edukimit islam dhe kryesisht kanë standarde të vjetëruara edu-

kative, arsimore dhe pedagogjike. Për këtë arsyen nuk i kuptojnë kahëzimet bashkëkohore të Bashkësisë Islame dhe të imamëve të tyre.

Në disa familje si mjet në procesin edukativ dominon forca fizike. Madje, disa prindër këtë mjet ia preferojnë edhe imamit, edukatorit apo mësuesit, sepse "dajaku ka dalë prej xhenetit". Me këtë rast gabohet dyfish:

- a) Për shkak të qëndrimit tonë rezistues, fëmija i zhvilllon mekanizmat mbrojtës: frikën, mashtrimin dhe forcën;
- b) Me sjelljet tona të forcës ne e neglizhojmë dhe e shpërfillim dinjitetin e tyre dhe e mohojmë individualitetin e fëmijëve, duke ua imponuar bindjet dhe maniret e kohës sonë.

3. Në xhematet tona nuk ekziston edukim sistematik familjar, andaj problemet zgjidhen nga rasti në rast, pa metoda dhe mjete përkatëse. Po ashtu, dallimi i prindërve në edukim ndikon shumë në formimin edukativ të njeriut të ri.

Në disa raste, disa prindër më shumë vëmendje i kushtojnë asaj sesi fëmija i tyre të mësojë sa më shumë, që nesër të krijojë një karrierë të mirë e të sigurt, sesa sjelljeve të fëmijës ndaj shokëve të tij, ndaj xhamisë, ndaj imamit, ndaj obligimeve fetare, ndaj Bashkësisë Islame etj. Ata shpesh i shpërblejnë fëmijët edhe për gjërat që ata duhen t'i bëjnë pa shpërblim. Këto devijime në relacionin prind - fëmijë, prindërit shpesh ia përshkruajnë imamit dhe Bashkësisë Islame me çka krijojnë bindje te fëmija se vetë fëmija dhe prindi nuk kanë gabime dhe se për gabimet e tyre janë fajtorë të tjerët.

Në shumë raste, sidomos nëpër fshatra, prindërit ndaj fëmijëve vendosin detyrime tejmase, si në blerje, punë fizike, ruajtje të kafshëve në kushte të ndryshme atmosferike, duke i harruar edhe nevojat e fëmijëve dhe mundësitë e tyre reale.

Në shumë raste, kur imami interesohet për gjendjen familjare të xhematliut, ai përgjigjet se ajo është mirë, edhe kur faktet dhe realiteti flasin ndryshe.

4. Ka xhematlinj që detyrimet e tyre ndaj islamit dhe Bashkësisë Islame i kuqojnë tepër ngusht. Ata mendojnë se nëse shkojnë në xhami, prejnë kurban e ndonjë veprim tjetër, i kanë përfunduar obligimet. Përkundrazi, xhematliu ndaj bashkësisë së vet fetare ka obligime të përhershme, ashtu siç ka obligime për vveten. Bashkësia Islame është një organizëm me nevoja të përhershme dhe, nëse ajo çalon, do të çalojë tërë shoqëria.

Faktor me rëndësi në këtë aspekt është edhe ajo se një pjesë e xhematit e qorton pjesën tjetër për shkak të sjelljeve të tyre në shpërputhje me fjalët dhe me vepritmet e tyre. Për shembull, disa pinë, luajnë bixhoz, nuk falen, nuk agjerojnë dhe jepen pas jetës joislame. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kush prej jush nuk preokupohet me problemet e muslimanëve, ai nuk është prej tyre.”

B. Vërejtjet e xhematlinjve ndaj imamit

Nga biseda me shumë xhematlinj, por edhe nga imamë të caktuar, të vetëdijshëm dhe real, mund të përfundojmë se vërejtjet më të shpeshta në adresë të imamit, por edhe të Bashkësisë Islame janë:

1. Imamët nuk kanë forma të fuqishme, të llojlojshme dhe sistematike të bashkëpunimit. Ligjëratat apo bashkëpunimi i ofruar është formal, shterpë, përplot fjalë të huaja (të panjohura për xhematliun), përplot kritika, vajtime dhe shitje mend në adresë të xhematit, kurse mun-

gojnë ligjératat têrheqëse ku xhematliu mund tê mësojë, ku mund tê këshillohet, ligjératat me kritikë reale pa u ndarë imami me "unë" dhe xhemati me "ju", ligjératat ku nuk sulmohet personaliteti i xhematliut, por vetëm dukuria negative te xhematliu me metoda tê përshtatshme, pa i ofenduar individët, mjedisin dhe, në përgjithësi, shoqërinë.

2. Disa imamë, xhematliun apo fëmijën e mësim-bessimt, nuk e angazhojnë sa duhet, kurse disa tê tjerë e angazhojnë më tepër se që duhet. Për arsyen objektive apo subjektive, disa imamë nuk e përcjellin në mënyrë sistematike gjendjen në xhematin e vet: sa falen, sa i kryejnë obligimet e tjera fetare, si e zhvillojnë afarizmin dhe çfarë sjellje kanë në jetën e përditshme. Po ashtu, disa imamë nuk janë objektiv dhe në shërbim tê drejtë ndaj të gjithë xhematlinjve njësoj, pa marrë parasysh gjendjen materiale apo pozitat e tjera shoqërore e qytetare.

3. Disa imamë janë jo tê qartë, konfuz, sipërfaqësorë dhe tê papërgatitur për temat që i ligjerojnë. Ata shpesht janë tê bezdissħem, tê pavullnetħem për biseda tê sin-qerta, tepër tê ndjeshem, me prirje kah cikerrimat e me vese tê tjera. Disa imamë harrojnë se kritika shpotitëse e tyre drejtar xhematlinjve para tê tjerëve nuk është produktive dhe se ajo do tê ndikojë keq në disponimin dhe atmosferën e përgjithshme në xhemat.

4. Shumica e imamëve nuk marrin pjesë në aktivitetet e xhematlinjve, respektivisht marrin pjesë vetëm në mënyrë sipërfaqësore. Ata fare pak angazhohen e preokupohen me organizimin e kohës së lirë tê xhematlinjve dhe formave tê argëtimit dhe rekreimit në kuadër tê disa solemniteteve fetare. Shumica e imamëve punën e tyre e reduktojnë ekskluzivisht brenda xhamisë, duke i injoruar çështjet e jetës islame jashtë xhamisë.

5. Ka shumë pak takime (tribuna, seminare, simpoziume, por edhe takime tê tjera) tê organizuara nga imami

apo Bashkësia Islame, në të cilat do të shqyrtoheshin problemet edukative bashkëkohore, problemet pedagogjike, psikologjike, filozofike e moderne, që janë në të mirë të xhematlinjve për t'i kuptuar realisht problemet, dobitë dhe dëmet e ofertave joshëse, por të trezikshme nga bota moderne evroperëndimore. Është mendim i xhematlinjve se imamët ofrojnë pak në këtë aspekt, madje thonë se imamët më tepër janë të preokupuar për vutura të mira, për banesa komfore dhe për trende moderne, sesa për blerjen e literaturës si mjet dhe vegël e zejes së tyre të imamit.

6. Xhematlinjtë i shqetëson sjellja e disa imamëve të cilët krijojnë përshtypje te xhematlinjtë se detyrimet fetare janë të rënda dhe se mësim-besimi nuk ka ndonjë vlerë. Me mosgatishmérinë e tyre që të punojnë, me mosardhjen e imamëve me rregull në mësim-besim dhe me metodat e dhunshme të disa imamëve gjatë procesit të mësim-besimit, imamët e tillë krijojnë bindje te xhematlinjtë se ata janë të papërgjegjshëm para Zotit dhe para njerëzve.

Këto dhe shumë lëshime të tjera në relacionin fëmijë - prind - imam - Bashkësi Islame, tregojnë se para faktorëve relevantë qëndrojnë obligime dhe detyrime serioze. Është joserioze dhe absurde që fenomeni xhemat - imam - organizatë fetare islame, nuk është studiuar aspak nga kompetentët. Ndoshta fajtori më i madh është vetë imami, i cili këtë detyrim është dashur ta kryejë vetë. Lexoni gazetat apo veprat e botuara dhe do të biddeni në faktin se xhamia, imami dhe xhemati janë temat më të rralla. Këto tema edhe atëherë kur shkruhen, janë anakronike, sterile dhe pa vizione. Nuk ka studime teologjike, historike, sociologjike, psikologjike e të tjera rrëth rolit dhe rëndësisë së kësaj teme.

“Ç’keni, përsë nuk i ndihmoni njëni-tjetrit.” (Es-Safat, 25).

VI. Planifikimi dhe format e bashkëpunimit ndërmjet imamit dhe xhematlinjve

“O besim drejtë, kinie parasysh frikën ndaj Allahut dhe le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër, dhe kinie frikë Allahun, e s’ka dyshim se Allahu është që e di në detaje atë që punoni”.
(El-Hashr, 18).

Çdo imam duhet ta ketë planin e tij vjetor të punës. Në këtë plan¹⁸ duhet të ketë vend patjetër edhe bashkëpunimi me xhematlinjtë. Ky plan nuk mund të jetë i përgjithshëm, por i veçantë, specifik dhe secili xhemat përvete, duke i shfrytëzuar parimet e përgjithshme. Së këndejmi, është mirë që çdo imam varësisht nga mundësitet e tij, koha e lirë, aftësitetë dhe niveli i xhematlinjve dhe rrethanave të tjera me të cilat ndeshet imami, t'i planifikojë format e bashkëpunimit me xhematlinjtë. Gjatë këtij planifikimi, duhet pasur parasysh metodat dhe format e deritashme të bashkëpunimit, të cilat me modifikime të caktuara, mund të ndihmojnë me rastin e planifikimit të planit vjetor.¹⁹

¹⁸ Me termin *planifikim* nënkuptojmë procesin e tubimit të informatave dhe të paraqitjes së supozimeve për të ardhmen në formulimin e veprimtarive të domosdoshme në realizimin e qëllimeve organizative.

¹⁹ Hisham Et-Talib, *Udhëzues përgatitor për punonjësit islamikë*, Shkup, 1419 h./1998, fq. 105-120.

Në vija të përgjithshme mund të themi se format vijuese janë pak a shumë të kapshme për shumicën e imamëve:

1. Kontaktet individuale ndërmjet imamit dhe xhematlinjve

Për bashkëpunim të përhershëm, të shkathitë dhe të suksesshëm ndërmjet imamit dhe xhematlinjve, nevojiten edhe kushte të caktuara: gatishmëri e sinqertë mes palëve për bashkëpunim, mundësitë kohore të imamit që të mbajë lidhje me xhematlinjtë për shkak të angazhimit të imamit, aftësitë pedagogjike dhe psikologjike të imamit, stimulimi material i imamit për një angazhim të tillë dhe ofrimi i kushteve nga ana e Bashkësisë Islame në hapësirë, literaturë dhe mjetet e tjera për informim të xhematlinjve etj.

Puna me xhematlinjtë kërkon nga imami siguri dhe pavarësi në punë, guxim dhe këmbëngulësi, drejtësi dhe humanitet, durim dhe zellshmëri, bujari dhe zemërgjëresi. Këto virtute do t'i japin imamit fuqi që t'i përveshet punës dhe në këtë mënyrë ta ngrejë dinjitetin e tij dhe, në përgjithësi, të Bashkësisë Islame.

Xhematlinjtë duhet të jenë të gatshëm për angazhim të përhershëm, entuziastë dhe kureshtarë për vetarsimim. Edhe xhematlinjtë duhet të tregojnë durim, humanitet, bujari dhe këmbëngulësi.

Të dyja palët duhet të jenë vizionarë, të kenë sens për risi dhe krijim, të jenë tolerantë dhe të shfaqin dëshirë për punë ekipore.

Përvoja e gjatë tregon se kontaktet ndërmjet xhematlinjve dhe imamit në xhami dhe jashtë saj janë forma

të pazëvendësueshme. Nëpërmjet këtyre kontakteve imami, gjëgjësisht Bashkësia Islame, drejtpërdrejt njoftohet me kushtet fetare dhe të tjera në xhemat, me gjendjen, nivelin dhe intensitetin e zbatimit praktik të ritualeve islame nga ana e xhematlinjve dhe me masat që duhet të ndërmerrën për shërimin e veseve të liga dhe përmirësimin apo avansimin e virtyteve të mira.

Takimet e ndërsjella shërbejnë edhe për ndërtimin e mirëkuptimit të ndërsjellë, respektimin dhe njoftimin me nevojat dhe kërkesat aktuale të bashkësisë islame në përgjithësi. Nga këtu rrjedhin edhe idetë dhe nismat e reja.

Mirëpo, kontaktet individuale mund të jenë edhe të dëmshme: nëse këto kontakte nuk përgatiten mirë, nëse imami i viziton vetëm ato familje që e ftojnë, apo vetëm ato familje të cilat eventualisht mund t'i sjellin kokëçarje, apo vetëm ato familje nga të cilat ka interes material (shpërblime).

Kontaktet individuale ndërmjet imamit dhe xhematlinjve kërkojnë përgatitje të shumta, kohë të lirë, durim dhe shkathtësi. Janë me vend edhe vërejtjet e imamëve se obligimet e shumta që i kanë, si pesë kohët e namazit, mësim-besimi, ligjératat dhe hutbet, si dhe shërbimet e xhenazeve, u marrin shumë kohë dhe u pengojnë për planifikim të saktë. Po ashtu, pengesë është edhe preokupimi i xhematlinjve me punët e përditshme për ekzistencë, ndonëse kanë dëshirë për takime dhe kontribute brenda mundësive.

Me rastin e organizimit të kontakteve ndërmjet imamit dhe xhematlinjve, individualisht apo në mënyrë grupore, imami duhet pasur parasysh disa rregulla të përgjithshme:

- Me xhematlinjtë duhet biseduar në mënyrë natyrore, njerëzisht e jo ftohtë, zyrtarisht, formalisht dhe me nënçmim;

- Nuk bën të kritikohen dhe të gjykohen vetëm veprimet e xhematlinjve, të theksohen vetëm pikat e dobëta dhe vetëm në bazë të këtyre pikave të jepen udhëzime dhe këshilla;

- Duhet gjetur mundësitë që pikat e dobëta të sheshohen pa qortime dhe ofendime dhe të ofrohet rrugëdalje me më pak dhembje;

- Të theksohen edhe gjërat pozitive në xhemat dhe të kemi kujdes që gjatë komunikimit fjalori të mos ngarkohet me fjalë të huaja të panevojshme;

- Duhet të kihet mirëkuptim për problemet në xhemat dhe të krijohet atmosferë mirëbesimi ndërmjet xhematit dhe organizatës islame.

Imami duhet ta vizitojë xhematliun, por edhe xhematliu duhet ta vizitojë imamin në vend të punës, por në raste të caktuara edhe në shtëpi. Këto vizita duhet të janë serioze, të sinqerta dhe solidare. Këto vizita imami do t'i bëjë kur të paraqitet nevoja, kushtet dhe mundësitë për vizitë. Me këtë vizitë imami njoftohet me rrethanat familjare të xhematliut, me shkallën e intensitetit fetar në familje dhe me eliminimin e veseve të liga. Takimi do të jetë i dobishëm nëse edhe xhematliu tregon dëshirë për avancimin e gjendjes fetare, nëse është kritik dhe vetëkritik ndaj gjendjes aktuale. Po ashtu takimi do të jetë i dobishëm nëse imami përgatitet për temat e mundshme që do t'i trajtojë me xhematliun, nëse e njofton me rrethanat botërore të islamit dhe me pozitën tonë në këtë vorbull, nëse bën shpjegime për kulturën dhe qytetërimin islam, për projektet e mundshme të bashkësisë islamë etj. Imami patjetër duhet të jetë kritik edhe ndaj vvetes dhe ndaj kolegëve, por edhe ndaj të tjerëve që e kanë sjellë gjendjen e krijuar. Ky propozim-projekt është i mundur nëse imami në xhematin e tij i ka 200-300 familje dhe obligimet e rregullta të imamit, e jo siç është

rasti në shumë xhemate te ne, ku disa imamë i kanë 500-1500 familje në terren, e në disa vende edhe më tepër, kanë edhe obligime të tjera, si profesorë në medrese, apo në fakultet, janë anëtarë të organeve apo institucioneve të Bashkësisë Islame dhe, normalisht, ata vetëm vrapijnë nga detyra në detyrë, nga honorari në honorar, duke mos arritur kështu t'i plotësojnë detyrimet e rregullta, madje edhe nëse do të dëshironin.

Vizita te xhematliu duhet të bëhet nga imami, kurse me propozim të imamit, me të është mirë të jetë edhe kryeimami apo edhe ndonjë anëtarë i Këshillit të Bashkësisë Islame. Kushdo që e bën vizitën, me kohë duhet ta zgjedhë kohën e përshtatshme, të caktohet koha, të mendohet për literaturën që duhet rekomanduar xhematliut për lexim dhe për udhëzime e këshilla praktike për kapërcimin e problemeve të caktuara në familje, por edhe për mbjelljen e dashurisë për institucionet e Bashkësisë Islame.

Temat më të shpeshta me xhematliun mund të jenë nga fusha e fikhut (jurisprudencës), ahlakut (etikës), akadimit (besimi), pedagogjisë islame, feve krahasimtare, tren-deve botërore, rreth lëshimeve të prindërve në rregullat e shariatit, me çka bëhen shembull i keq për fëmijët (sepse shumë prindër konsumojnë duhan, kurse një numër i tyre edhe alkool, disa luajnë bixhoz, e disa janë të pamoralshëm, kanë sjellje kriminele etj.). Prindërit, e sidomos vijuesit adoleshentë e madhorë të mësim-besimit, duhet të marrin udhëzime për jetën bashkëshortore, për fjesën dhe martesën islame, për higjenën islame të bashkëshortëve etj. Këto takime duhet të jenë të dobishme, të sin-qerta dhe platformë për përgjegjësi edhe më të mëdha.

Ndonëse janë më të rralla dhe më pak praktike (për shkak të numrit të madh të xhematlinjve), megjithatë duhet të ekzistojnë edhe vizitat e xhematlinjve te imami

dhe, patjetër, vizitat e xhematlinjve në Bashkësinë Islame. Këto vizita i forcojnë lidhjet e xhematlinjve dhe imamit. Xhematliu duhet të ketë për qëllim që me këtë vizitë të njoftohet me imamin, me Bashkësinë Islame, me problemet dhe obligimet e tij ndaj organizatës fetare, por edhe me të drejtat që i ka organizata ndaj tij. Xhematliu do të merrte preferimin e punëtorit fetar për parapagim të gazetave fetare, të librave më të nevojshëm për familjen e tij, por edhe me mundësinë që ai në objektet e Bashkësisë islame të mund t'i lexojë gazetat dhe librat që i mungojnë apo që nuk mund t'i blejë.

Kontaktet individuale mund të jenë edhe nëpërmjet letër-këmbimit, telefonit, internetit dhe mjeteve të tjera komunikuese, nëse imami dhe xhematliu, për arsyе të caktuara nuk mund të kontaktojnë fizikisht. Këto forma, por edhe format e tjera që në vende dhe kohë të caktuara tregohen të arsyeshme, duhet pasuruar dhe kultivuar vazhdimisht.

2. Mbledhjet prindërore

Mbledhjet prindërore apo mbledhjet me prindërit e vijuesve të mësim-besimit në Bashkësinë Islame dhe tek imamët tanë mbahen tepër e rrallë. Edhe aty ku ekzistonë mbledhjet prindërore ato janë josistematiqe, të paorganizuara, stihike dhe kuantitativisht të parëndësishme. Mirëpo, nëse mbledhjet prindërore ekzistojnë, ato duhet përsosur, e nëse nuk ekzistojnë, duhet organizuar, përgatitur me takt, me sinqeritet dhe me vullnet të mirë. Mbledhjet duhet ta përfshijnë tërë xhematin, sipas niveleve të mësim-besimit apo të punkteve të mësim-besi-

mit, respektivisht imami duhet të organizojë mbledhje varësisht nga mënyra e organizimit të xhematit të caktuar. Në ato mbledhje imami duhet t'i theksojë së pari pikat pozitive të nxënësve apo të prindërve, e pastaj pikat negative, duke pasur kujdes maksimal që mos të ofendohet palët “e sulmuara”. Do të ishte e preferueshme që negativitetet të shqyrtohen me vetë palët e gabimeve të interesuara për përmirësimë në hapësirë të veçantë. Mendojmë se lidhur me këtë temë duhet t'i kemi parasysh këshillat dhe veprimet e Muhammedit a. s..

3. Arsimimi i përgjithshëm dhe pedagogjik islam

Nevojat e shekullit XXI, rritja e vrullshme e shkençës dhe teknikës dhe dinamika e përshpejtuar jetësore, shtrojnë para faktorëve kompetentë për arsimim dhe edukim, në rastin konkret para imamit (dhe Bashkësisë Islame) dhe xhematlinjve-prindër, gjetjen e mënyrave dhe formave më frytdhënëse për arsimimin dhe edukimin e brezit të ardhshëm. Për bartjen e këtij misioni, para imamit, por edhe para xhematlinjve-prindër, imponehet përgatitja e përgjithshme kulturore, pedagogjike dhe psikologjike. Përgatitja e mirëfilltë mundëson marrjen dhe zbatimin e obligimeve në mënyrë të suksesshme dhe plotësimin e premtimeve dhe shpresave të vijuesve të mësim-besimit. Kjo formë e kontaktit sendërtohet në-përmjet ligjératave fetare të përgjithshme dhe të rastit (siç janë ligjératat e netëve të mëdha, ligjératat me rastin e fejesave, martesave, lindjeve, vdekjeve, ngjarjeve historike, ndërtimit të xhamive etj.), këshillimeve (vazeve) fetare, hutbeve të xhumave dhe bajrameve, tribunave, se-

minareve, sesioneve e simpoziumeve shkencore dhe të formave të tjera organizative: nëpërmjet mediumeve të shkruara (gazetave, revistave dhe librave) dhe atyre elektronike (radiotelevizioneve dhe internetit), brenda dhe jashtë Bashkësisë Islame dhe brenda dhe jashtë kufijve, në gjuhën amtare dhe në gjuhë të huaja.

4. Organizimi i aksioneve të përbashkëta në xhemat

Këshillat e Bashkësisë Islame apo këshillat e xhemateve gjatë vitit organizojnë aksione të ndryshme brenda territorit të tyre. Këtu do të bënte pjesë aksioni për pasrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve fetare dhe qytetare, ndërtimi i xhamive të reja, rindërtimet apo meremëtimet e xhamive të vjetra, shënimë i jubileve të personaliteve fetare, shkencore dhe historike, të objekteve të rëndësishme, organizimi i zijkeve të tjera, në këshillin vendor të Bashkësisë Islame, në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, në Medrese, në Fakultetin e Studimeve Islame dhe në qendrat e ndryshme në vend dhe jashtë etj.

Të gjitha këto aksione apo vizita, Bashkësia Islame apo imami i caktuar, duhet t'i përgatitin mirë. Nëse ndërtohet apo meremetohet një xhami e re, këshilli nismëtar duhet të jetë i singertë, transparent, i saktë dhe në çdo çast i gatshëm të ofrojë llogari.

Nëse vizitohet një qytet apo një objekt historik, organizatori duhet të përgatitë të dhëna të bollshme për vizitorët, t'i njoftojë ata historikisht dhe fetarisht për të ka-

luarën dhe domethënien e objektit të caktuar për ardhmërinë.

Xhemtlinjtë-prindër do të afrohen dhe do të ofrojnë më tepër nëse e gjejnë veten në këto aksione. Nëse e shohin vetveten brenda aksionit, ata do ta shtojnë angazhimin dhe përgjegjësinë për aktivitetin e caktuar dhe kështu do të rritet roli edukativo-arsimor i imamit në xhematin e tij.

5. Bibliotekat, sallat e leximit, lokalet për pushim, argëtim e rekreim

Edhe përkundër gjendjes së rëndë ekonomike në vendin tonë, në Bashkësisë Islame dhe në xhemat, çdo xhami duhet t'i marrë parasysh mundësitë materiale dhe hapësinore për vendosjen dhe aktivizimin e bibliotekës së xhamisë, sallës së leximit dhe ndonjë sallëje për pushim dhe rekreim. Biblioteka duhet të pasurohet me të gjitha veprat e nevojshme për vizitorët e saj aktiv (ata që falen) dhe pasiv (ata që ende hamenden, por që bibliotekën e vizitojnë për qëllime të tjera).

Po ashtu, këshillat komunal islam pa vonesë duhet t'i konstituojnë bibliotekat publike për besimtarët dhe lexuesit e tjerë, në selinë e Këshillit BI, apo edhe në objekte të veçanta. Biblioteka duhet të pasurohet me literaturë të përgjithshme, por edhe me literaturë specialistike për nevojat e kuadrit fetar dhe të hulumtuesve të tjerë, me gazeta, revista informative dhe shkencore, me vjetar dhe publikime të tjera, dhe ato në gjuhë të rrëthit ku jetojnë besimtarët. E njëjta vlen edhe për Bashkësinë Islame, e cila pa kurrfarë vonese duhet ta konstituojë një bib-

liotekë publike qendrore me të gjitha rregullat e bibliotekave universitare e kombëtare.

Këto biblioteka duhet të kenë hapësirë për biseda imam-xhematli dhe për imamët ndërmjet vete, pastaj duhet të ekzistojnë hapësira për debate shkencore, për shpjegime dhe ligjérata të kohëpaskohshme dhe për hulumtime shkencore, me teknikën bashkëkohore për punë: telefon, aparate për fotokopjim, mikrofilmim, internet etj.²⁰

6. Pjesëmarrja e xhematlinjve në fushat e tjera të jetës dhe të punës së xhematit

Bashkëpunimi ndërmjet imamit, Bashkësisë Islame dhe xhematlinjve nuk mund të shteret me format e propozuara. Ai duhet të pasurohet nga koha në kohë dhe nga vendi në vend. Ky bashkëpunim mund të pasurohet edhe nëpërmjet zgjedhjes në Këshillin e xhematit të xhamisë, zgjedhjes në Këshillin e Bashkësisë Islame dhe zgjedhjes në organet dhe institucionet e Bashkësisë Islame, në Këshillin e përgjithshëm të medreseve, të komisioneve të ndryshme të përkohshme, të qendrave islame në diasporë etj.

Në hartimin e planit të përgjithshëm për bashkëpunim ndërmjet imamit dhe xhematlinjve duhet të marrin pjesë përfaqësuesit e xhematlinjve, imami i xhamisë përkatëse dhe kryeimami i vendit përkatës. Në këtë duhet pasur parasysh këto pika:

²⁰ Si të shfrytëzohen mjetet audio-vizuele: Hisham Et-Talib, *Udhëzues përgatitor për punonjësit islamikë*, Shkup, 1419 h./1998, fq. 257.

- Në planin dhe programin vjetor të përfshihen të gjithë faktorët e rëndësishëm për bashkëpunim të sukseshtëm ndërmjet imamit dhe xhematlinjve;

- Të gjitha format e bashkëpunimit t'i përshtaten nivelit intelektual dhe moshës së xhematlinjve dhe mundësive të tjera;

- Përbajtja e punës së imamit dhe e xhematlinjve duhet t'u përshtatet kushteve konkrete të imamit dhe xhematlinjve, por kjo s'do të thotë se gjendja e dobët dhe kushtet e vështira për punë janë arsyё për ta lënë aktivitetin. Edhe nga gjendja e rëndë mund të arrihen suksese, aq më tepër kur shpresa është kusht për çdo besimtar musliman.

Në këtë plan dhe program duhet të vlerësohen dhe miratohen edhe format e deritashme të pëlqyera dhe të miratuara nga xhematlinjtë. Sidomos duhet dhënë rëndësi atyre formave që deri tash i kanë zbuluar, analizuar dhe eliminuar problemet thelbësore edukativo-arsimore dhe problemet e tjera në mjedisin e caktuar.

Në kushtet e bashkëpunimit të konceptuar mirë, të planifikuar me shkathtësi dhe të sendërtuar me sukses ndërmjet imamit dhe xhematlinjve ka mundësi që besimtarëve t'u ofrohet ndihmë më e madhe dhe më konkrete në të kuptuarit e islamit. Në këtë aspekt ndihmon sigurimi i librave dhe doracakëve fetarë. Në tërë këtë angazhim duhet të përfillen parimet e pedagogjisë islamie.

Nëse përfillen të gjitha çështjet e theksuara, roli dhe dinjiteti i imamit do të ngrihet, ai do të jetë më i respektuar në organet e Bashkësisë Islamë dhe para qytetarëve, gjë që do ta obligojë imamin që në të ardhmen ta punojë edhe më me përkushtim. Po ashtu, nga ky transformim fitojnë edhe xhematlinjtë: ata e trisin nivelin e tyre fetar dhe kulturor, i zgjidhin më lehtë problemet e përditshme fetare dhe edukativo-arsimore dhe kështu sigurojnë jetë më të lumtur në këtë dhe në botën tjeter.

VII. Literatura e konsultuar:

Për të fituar një dije solide dhe informacione me rëndësi nga kulturat e ndryshme botërore, rekomandojmë leximin e disa veprave:

1. Bellenger, Lionel, *Umijeće komuniciranja*, Sarajevë, 1992.
2. Carnegie, Dale, *Psihologija Uspjeha*, libri I, II, III, Zagreb, 1982.
3. Et-Talib, Hisham, *Udhëzues përgatitor për punonjësit islamikë*, Shkup, 1419 h./1998.
4. *Hadithe të zgjedhura të Pejgamberit alejbisselam*, (zgjodhi Jakup Memiq), Tetovë, 2003.
5. Ilić, Miloš, *Sociologija kulture i umjetnosti*, botimi VI, Beograd, 1980.
6. Jeken, Fethi, *Islamic Movement*.
7. *Kur'ani – Përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, përkthimi nga Sherif Ahmeti, Medine.
8. *Kushtetuta e Bashkësisë Islame*, Prishtinë, 2002.
9. Salihspahić, Dzemal, *Saradnja džematlija i imama*, Sarajevë, 1983.

**Nexhat Ibrahimi
IMAMI DHE XHEMATI**

Boton: **Logos-A**
Biblioteka: **Mendimi Islam**

Për botuesin: **Adnan Ismaili**
Kryeredaktor: **Husamedin Abazi**
Redaktor biblioteke: **Nexhat Ibrahimi**

Redaktor gjuhësor: **Zekeria Ibrahimi**
Redaktor artistik & Disenjator: **Edi Agagjshi**
Faqosës: **Afrim Gashi**

Mbikëqyrës i shtypit: **Imer Gogufi**
Përgatitja kompjuterike: **Focus Pro - Shkup**
Shtypi: **Focus - Shkup**

Copyright © Logos-A, 2005

Shënim i CIP katalogut i këtij libri gjendet
në Bibliotekën Kombëtare Universitare
ISBN 9989-58-169-X

www.logos-a.com





ISBN 998958169-X



9 789989 581694

Copyrighted material